

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS, kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Emine Kaçiku, kryetare, Mr.sc. Muhamet Rexha dhe Erdogan Haxhibeqiri, anëtarë, në çështjen juridike të paditësit Compania "B. C." sh.a. me seli në Gjilan, të cilën e përfaqëson sipas autorizimit B. L., avokat nga Prishtina, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor Bardhosh Dalipi, për shkak të borxhit, vlera e kontestit 787.522,48 €, përkitazi me revizionin e paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë Ae.nr.178/2016 datë 21.3.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur më 31.7.2018, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si i pabazuar revizioni i paditësit, paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë, Ae.nr.178/2016 datë 21.3.2018.

A r s y e t i m i

Me aktgjykimin e Gjykatës së Apelit të Kosovës, Prishtinë Ae.nr.178/2016 datë 21.3.2018, është refuzuar si e pabazuar ankesa e paditësit, dhe është vërtetuar aktgjykimi i Gjykatës Themelore Prishtinë, Departamenti për Çështje Ekonomike, IV.C.nr.570/14 datë 12.7.2016, me të cilin me pjesën I të dispozitivit është refuzuar si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit, që të obligohet e paditura t'ia

paguajë shumën prej 787.522,48 €, në emër të borxhit për kryerjen e punëve ndërtimore, shtruarjen e rrugëve, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% duke filluar nga data 28.12.2011, e deri në pagesën definitive, si dhe t'ia paguaj shpenzimet gjyqësore në shumën prej 1270 €, të gjitha në afat prej 15 ditësh, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm. Me pjesën II të dispozitivit është vendosur që secila palë t'i bartë shpenzimet e veta.

Kundër aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë paditësi me kohë ka paraqitur revizion, për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale dhe tejkalimit të kërkesëpadisë, me propozim që aktgjykimet e gjykatave të instancës më të ulët të prishen ose ato të ndryshohen, ashtu që të aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditësit.

Gjykata Supreme e Kosovës, pas shqyrtimit të aktgjykimit të goditur sipas nenit 215 të LPK, ka gjetur se:

Revizioni është i pabazuar.

Nga shkresat e lëndës del se paditësi dhe e paditura nuk kanë qenë në ndonjë raport kontraktues. Paditësi punët ndërtimore – shtruarjen e rrugëve, i ka kryer në bazë të porosisë me mesazhe telefoni nga kryetari i komunës Q. M., i cili me vendim (pa datë dhe numër të protokollit), emëron komisionin prej tre anëtarëve për hartimin dhe vlerësimin e parametrave për shtruarjen e rrugëve me zhavorr në fshatin Vërbicë dhe Zhegovc. Ky komision më datë 28.11.2011 ka bërë raportin të cilin ia ka dërguar kryetarit të komunës, menaxheres së zyrës së prokurimit dhe menaxherit të zyrës së projekteve, ndërsa e kanë llogaritur çmimin e kryerjes së

punëve në bazë të parametrave dhe parallogarisë të cilat ua ka ofruar punë kryesi. Për punët e kryera nuk është formuar ndonjë komision për pranim – dorëzim teknik të këtyre punëve.

Paditësi me padi ka kërkuar që të obligohet e paditura t’ia paguajë shumën prej 787.522,48 €, në emër të borxhit për kryerjen e punëve ndërtimor, shtruarjen e rrugëve.

Gjykata e shkallës së parë, pas administrimit të provave ka gjetur se kërkesëpatria e paditësit është e pabazuar, ngase kontrata e ndërtimit duhet të lidhet në formën me shkrim, siç është paraparë me dispozitën e nenit 630.2 të LMD –ës, ndërsa neni 70.1 i ligjit të cekur ka përcaktuar se kontrata që nuk është lidhur në formën e parashikuar, nuk prodhon efekt juridik, pastaj ka vendosur si në dispozitivin e atij aktgjykimi.

Gjykata e shkallës së dytë në procedurën sipas ankesës në tërësi ka pranuar konstatimet faktike dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, ka refuzuar ankesën e paditësit, ndërsa aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë e ka vërtetuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë e çështjes, ka gjetur se gjykatat e instancës më të ulët, duke vërtetuar drejt dhe në mënyrë të plotë gjendjen faktike, drejt kanë zbatuar të drejtën materiale, kur kanë gjetur se kërkesëpatria e paditësit është e pabazuar. Aktgjykimi i goditur dhe ai i gjykatës së shkallës së parë përmbajnë arsye të mjaftueshme për faktet relevante të vlefshme për gjykimin e drejtë të kësaj çështje juridike, të cilat janë të pranueshme edhe për

këtë gjykatë, ndërsa nuk përmban shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore për të cilat kjo Gjykatë kujdeset sipas detyrës zyrtare.

Thëniet e paditësit në revizion, se aktgjykimi është marrë me shkelje thelbësore nga neni 182 par. 2 pika (n) të LPK, siç theksohet, se gjykata e shkallës së parë me rastin e marrjes së vendimit e ka ngatërruar bazën juridike të kërkesëpadisë, të cilën e trajton si borxh nga kontrata e ndërtimit, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se në kuptim të nenit 253.2 të LPK –ës gjykata nuk është e lidhur me bazën juridike të kërkesëpadisë. Sipas dispozitës së cekur, pala ka për detyrë të ofrojë gjendjen faktike, sepse bazën juridike të kësaj gjendje faktike e njuh vet gjykata.

Përkundër kësaj, kjo Gjykatë shton se i autorizuari i paditësit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nga gjendja faktike është vërtetuar se e paditura i ka borxh paditësit shumën prej 788.522,48 € , të cilën shumë ka kërkuar që e paditura t'ia paguaj, andaj pretendimi i revizionit se paditësi kërkesëpadinë e ka bazuar në dispozitat e nenit 194 par.1, 2 e 3 të LMD-ës, nga Gjykata Supreme e Kosovës u vlerësua si i pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, i ka vlerësuar si të pabazuara thëniet e revizionit, që kanë të bëjnë me zbatimin e gabuar të së drejtës materiale, sepse nisur nga gjendja e vërtetuar faktike, del se paditësi me të paditurën nuk kanë lidhur kontratë me shkrim siç e parasheh neni 630. 2 të LPK –ës i cili nen ka përcaktuar se kontrata e ndërtimit lidhet në formën me shkrim, ndërsa neni 70.1 i ligjit të cekur ka përcaktuar se kontrata e cila nuk është e lidhur në formën e parashikuar, nuk ka efekt juridik.

Me të drejt gjykata e shkallës së dytë ka konstatuar se ndërmjet palëve nuk është nënshkruar kurrfarë kontrate mbi ndërtimin me të cilën do të ishin caktuar të drejtat dhe detyrimet e ndërsjella të palëve, andaj konstatimin se nuk ka bazë të vlefshme juridike për realizimin e shpërblimit të këtyre punimeve, si të drejt e të bazuar në ligj e vlerëson edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Nga fakti se paditësi ka dështuar të argumentoi se me të paditurën ka krijuar marrëdhënie detyrimore, pretendimi i cekur në revizion lidhur me zbatimin e nenit 4 të LMD –ës në rastin konkret u vlerësua si i pabazuar. Gjithashtu nga arsyet e cekura më lart nuk gjen zbatim as neni 6 i ligjit të cekur, sepse nuk janë krijuar marrëdhëniet juridike ndërmjet pjesëmarrësve.

Andaj, qëndrimin juridik se kërkesëpadia e paditësit është e pabazuar, si të drejtë e të bazuar në ligj e aprovon edhe kjo Gjykatë e revizionit.

Pretendimi i cekur në revizion se aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë nuk përmban arsye të mjaftueshme lidhur me pretendimet e ankesës, kjo Gjykatë i vlerësoi si të pabazuara, ngase kur gjykata e shkallës së dytë e vërteton aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë, sikurse në rastin konkret, arsyetimi i aktgjykimit të gjykatës së shkallës së dytë që duhet të paraqes përgjigje ndaj arsyeve të ankesës, është i mjaftueshme kur i referohet arsyeve të aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë, të cilat i ka çmuar si të drejta, sikurse ka vepruar drejt gjykata e shkallës së dytë. Përndryshe, përsëritja e arsyeve nga aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë do të ishte i panevojshëm. Në revizion nuk është cekur asnjë pretendim se për cilat fakte gjykata e shkallës së dytë nuk ka dhënë arsyetim, ndërsa sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, aktgjykimi i gjykatës së

shkallës së dytë përmban arsye të bollshme për një gjykim të drejt e të bazuar në ligj.

Nga sa u tha më lart, e me zbatimin e nenit 222 të LPK, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS – PRISHTINË

E.Rev.nr.20/2018, datë 31.7.2018

Kryetarja e kolegjit,

Emine Kaçiku